



VENDIM

Nr. 108 Datë 14.11.2014

PËR

LICENSIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”; 9 dhe 13 pika 1, gërma “d” të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “g”; 13 dhe 14, të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EFT Albania” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “EFT Albania” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtorja e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për:

VENDIM

Nr. 108 Datë 14.11.2014

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “EFT ALBANIA” SH.P.K., NË
AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
